



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

RAPORT PËR ARSIMIMIN QYTETAR DHE ARSIMIMIN E VOTUESVE NË MAQEDONINË E VERIUT

Përmbajtja

- 01 Qëllimet e projektit dhe shfrytëzuesit e projektit
- 02 Metodologjia e hulumtimit
- 03 Demografia e hulumtimit
- 04 Gjendja e përgjithshme
- 05 Njohja dhe interesi për arsimimin qytetar dhe arsimimin e votuesve
- 06 Arsimimi qytetar formal dhe joformal dhe arsimimi i votuesve
- 07 Pjesëmarrja qytetare
- 08 Zgjedhjet
- 09 Perceptimi për KSHZ-në
- 10 Rëndësia e mediave për arsimimin qytetar dhe arsimimin e votuesve
- 11 Gjetjet kryesore

PROJEKT PËR MBËSHTETJEN E REFORMAVE ZGJEDHORE

QËLLIMET DHE SHFRYTËZUESIT E PROJEKTIT

- Projekti „Mbështetje të reformave zgjedhore në Maqedoninë e Veriut“ është projekt i Qeverisë së Zvicrës dhe implementohet nga Fondacioni ndërkombëtar për Sisteme zgjedhore (IFES). Qëllimi kryesor i projektit është që t'i mbështesë proceset zgjedhore demokratike dhe kredibile që e lehtësojnë pjesëmarrjen politike dhe integrimin social, duke i mundësuar votuesit të zgjedhin lirshëm përfaqësuesit e tyre dhe t'i thërrasin në përgjegjësi.
- Aktivitetet e projektit kanë për qëllim të mbështesin përmbushjen e tre rezultateve:
 - Rezultati 1: Institucionet e fuqizuara zbatojnë procese zgjedhore të drejta dhe efikase.
 - Rezultati 2: Demokratizimi i brendshëm i partive politike prezantohet nga politikantët dhe programet zgjedhore me orientim qytetar.
 - Rezultati 3: Qytetarët kërkojnë përgjegjësi nga partitë politike dhe përfaqësuesit e zgjedhur.
- Shfrytëzues të projektit janë organet për udhëheqjen me zgjedhjet në të gjitha nivelet, institucionet qeveritare si Ministria e shoqërisë informatike dhe administratës, Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audio vizuale, Enti shtetëror i statistikës, Avokati i popullit, Enti shtetëror i revizionit, Ministria e punëve të brendshme, Ministria e drejtësisë; partitë politike, organizatat qytetare, votuesit dhe qytetarët në përgjithësi.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT



Intervista të thelluara me profesionistë kyçë

15 intervista të thelluara me përfaqësues të: Byrosë për Zhvillimin e Arsimit, KSHZ-së, Partive politike, OJQ-ve/ Organizatave qytetare, Mediave, Akademisë/ Fakultetit për Shkenca politike



CAPI hulumtim përfaqësues kombëtar ballë për ballë

Mostër përfaqësuese kombëtare, me shtresim shumënivëlësh prej **1.114** të anketuar të moshës 18+, qytetarë të Republikës së Maqedonisë së Veriut
Margjina e gabimit ± 2.94 pikë përqindjeje në intervalin e besimit 95%
Korniza kohore: 15 - 26 qershor 2023



Fokus grupe me qytetarë nga gjashtë njësi zgjedhore

6 fokus grupe të qytetarëve të moshës 18+, në 6 njësi zgjedhore, të balancuara në lidhje me moshën, gjininë, përkatësinë etnike dhe statusin e marrëdhënies së punës


GJENDJA E PËRGJITHSHME

GJENDJA E PËRGJITHSHME – ASOCIACIONET

Gjetje nga
hulumtimi cilësor-
fokus grupe

Nëse duhet ta përshkruani gjendjen momentale në vendin tonë me tre fjalë, cilat do të ishin ato?


■ PERCEPTIM NEGATIV I SHPREHUR PËR SITUATËN AKTUALE NË VEND



PROBLEMET MË KRYESORE

Cili është problemi I PARË më kryesor me të cilin përballet vendi ynë sot?

Cili është problemi I PARË më kryesor me të cilin përballeteni Ju dhe familja Tuaj sot?




PROBLEMIT PARË MËT
RËNDËSISHËM

VËREJTJE

- **Krimi, korrupsioni dhe sundimi i së drejtës** më së shpeshti përmenden si problem me të cilin përballet vendi ynë, ndërkaj me rrallë si problem me të cilin përballeten qytetarët personalisht.
- **Ekonomia dhe standardi jetësor** më së shpeshti përmenden nga ana e maqedonasve etnikë, nga të anketuarit me arsim më të ulët dhe të anketuarit me të ardhura më të ulëta familjare.
- **Krimi, korrupsioni dhe sundimi i së drejtës** më së shpeshti përmenden nga të anketuarit e bashkësive të tjera etnike, të anketuarit me arsim të lartë dhe me të ardhura më të larta familjare.


TË INTERESUAR PËR ZHVILLIMET SOCIO-POLITIKE

Sa jeni të interesuar për zhvillimet aktuale socio-politike në vendin tonë?




Baza: 1114 (të gjithë të anketuarit)
Margjina e gabimit ± 2.94


Përqindja e të anketuarve të cilët nuk janë të interesuar për zhvillimet aktuale shoqërore - politike, sipas gjinisë



Përqindja e të anketuarve të cilët nuk janë të interesuar për zhvillimet aktuale shoqërore - politike, sipas grupmoshës




Përqindja e të anketuarve të cilët nuk janë të interesuar për zhvillimet aktuale shoqërore - politike, sipas nivelit arsimor



BESIMI NË INSTITUCIONET

Deri në cilën shkallë besoni ose nuk besoni në...?



**NJOHJA DHE INTERESI PËR ARSIMIMIN QYTETAR DHE
ARSIMIMIN E VOTUESVE**

ASOCIACIONE SPONTANE

Gjetje nga
hulumtimi
cilësor

Kur do ta dëgjoni nocionin **ARSIMIMI QYTETAR** çfarë **asociacionesh** ju vinë ndërmend?

Kur do ta dëgjoni **ARSIMIMI I VOTUESVE** çfarë **asociacionesh** ju vinë ndërmend?



ARSIMIMI QYTETAR

- ✓ Qytetarët t'i dinë të drejtat dhe detyrimet e tyre
- ✓ Qytetarët t'i kërkojnë të drejtat dhe liritë e tyre
- ✓ Të drejtat dhe detyrimet e pushtetit ndaj qytetarëve
- ✓ Qytetarët të dinë ku të kërkojnë ndihmë
- ✓ Mënyrat e pranueshme të sjelljes, morali dhe etika
- ✓ Bashkëpunimi i ndërsjelle i qytetarëve
- ✓ Lëndë mësimore në arsimin fillor
- ✓ Bazat e demokracisë


ARSIMIMI I VOTUESVE

- ✓ Njohja e rregullave të votimit në ditën e zgjedhjeve
- ✓ Mënyra e votimit
- ✓ Njohuri në cilin vendvotim të votojë
- ✓ Të dijë se ku t'i paraqesë parregullsitë
- ✓ Proces zgjedhor
- ✓ Njohje me programet e partive politike
- ✓ Njohje me kandidatët e partive politike
- ✓ Sigurimi i informacionit të rëndësishëm për të rinjtë rreth votimit dhe procesit të votimit



TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË QYTETARE

Sa pajtoheni ose nuk pajtoheni me deklaratën në vijim: „ Është e rëndësishme që qytetarët të njohin të drejtat dhe detyrimet e tyre në një shoqëri demokratike“?




Mendoj se nëse nuk ka Arsimim qytetar të mjaftueshëm nuk do të mund t'i realizojmë disa nga të drejtat tona, as që do të dimë se kemi mundësi për t'i realizuar ato.

Pjesëmarrës i fokus grupit, Tetovë

NJOHURI

Sa mendoni se keni njohuri për...:



Baza: 1114 (të gjithë të anketuarit)
Margjina e gabimit ± 2.94

NJOHJA E ARSIMIMIT QYTETAR DHE ARSIMIMIT TË VOTUESVE



INTERVISTA TË THELLUARA

- Të gjitha palët e prekura të intervistuarra pajtohen se qytetarët aspak ose shumë pak janë të informuar dhe i kuptojnë konceptet të cilat janë pjesë e arsimit qytetar dhe arsimit të votuesve

Ndonëse kemi shoqëri fuqishëm të politizuar, përgjithësisht qytetaria nuk i kupton konceptet e arsimit qytetar
Intervistë e thelluar me përfaqësues të partisë politike

Opinion i publik shumë pak e kupton se çka është Shoqëria civile, çka janë organizatat civile (qytetare), cili është roli i tyre, si janë financuar etj. Supozoj se shpesh herë ka barazime, madje edhe me partitë... Kështu që, në këtë plan mendoj se ka shumë mosdije se kush është kush në shoqëri.

Intervistë e thelluar me përfaqësues të mediave

FOKUS GRUPE


- Në shkallën shkollore (prej 1 deri në 5) nxënësit në fokus grupet vlerësojnë njohuritë e qytetarëve për arsimimin qytetar me notë mesatare ndërmjet 2 dhe 3.
- Si **shkaqe** më të shpeshta të njohjes relativisht të ulët të arsimit qytetar u theksuan këto:
 - ✓ Nënshtrimit të manipulimeve nga ana e sistemit dhe institucioneve
 - ✓ Ndjenjës së pashpresës dhe apatisë, që çon në pasivitet qytetar
 - ✓ Rënie të sistemit të vlerave morale në vend
 - ✓ Ngecje, varfëri
 - ✓ Shpërngulja e të rinjve nga shteti

Sa më pak informacione që kemi për aq i nënshtrohemi manipulimeve. Nuk është detyrim që çdo kush të dijë çdo gjë, megjithatë për të mirën tonë duhet të dimë sadopak se si funksionon sistemi që ndonjë të mos "na mashtrorë", do të shprehesh kështu.
Pjesëmarrës i fokus grupit, Manastir



INTERESIMI

Sa jeni të interesuar që të mësoni për...?



Baza: 1114 (të gjithë të anketuarit)
Margjina e gabimit ± 2.94

INTERESIMI I QYTETARËVE PËR ÇËSHTJET LIDHUR ME ARSIMIMIN QYTETAR DHE ARSIMIMIN E VOTUESVE

INTERVISTA TË THELLUARA

- Përfaqësues të Organizatave joqeveritare dhe të Mediave konsiderojnë se **qytetarët nuk janë shumë të interesuar** në temat lidhur me Arsimimin qytetar dhe Arsimimin e votuesve, ngase këto tema nuk janë shumë tërheqëse për qytetarët, para së gjithash, për shkak të ndjenjës së apatisë dhe pafuqisë që të ndryshojnë diçka në shoqëri

Qytetarët nuk janë të interesuar nga shkak se mendojnë se asgjë nuk mund të ndryshojnë

Intervistë e thelluar me përfaqësues të sektorit të OIQ-së

FOKUS GRUPE

- Arsyet më të zakonshme për shkak të cilave ekziston mosinteresi për këto tema për pjesëmarrësit e fokus grupeve janë këto:
 - **Asociacioni i arsimimit qytetar dhe arsimimit për votuesit me temat politike** që krijon rezistencë të fuqishme dhe nevojë për shmangien e tyre
 - **Zhvendosja e përgjegjësisë** te sistemi dhe institucionet dhe mospranimi i pjesës personale të përgjegjësisë (për të qenë i informuar dhe aktiv si qytetar)
 - **Dëshpërim dhe mosbesim** në institucionet dhe në shtet
 - **Perceptimi se arsimimi është për të rinjtë** dhe duhet të mbetet në kuadër të sistemit shkollor, detyrimisht në arsimin fillor, ndërsa si lëndë zgjedhore në arsimin e mesëm)

Thjeshtë nuk jam e interesuar. Aq shumë jemi të bombarduar në të gjitha lajmet, me të gjitha këtë informacione dhe jemi të stërngopur

Pjesëmarrës i fokus grupit, Manastir



INTERESIMI I QYTETARËVE PËR ÇËSHTJET LIDHUR ME ARSIMIMIN QYTETAR DHE ARSIMIMIN E VOTUESVE

FOKUS GRUPET

Në ç 'mënyre duan të informohet qytetarët?

- **Fushata të organizuara për rritjen e informimit të qytetarëve** nga shteti në bashkëpunim me sektorin joqeveritar
- **Broshura të shkurtra/ doracakë në version të shtypur ose onlajn** që do të shpërndahen përmes kanaleve të ndryshme dhe në të cilat qytetarët do të kenë qasje të shpejtë
- **Video të shkurtra, interesante dhe informative në terminët kryesorë në televizione, si dhe në mediat sociale**
- **Përfshirja e qytetarëve në debate, tribuna dhe diskutime** gjatë marrjes së vendimeve në nivelin vendor përmes sektorit joqeveritar

Ç 'duhet të bëjnë institucionet që të nxisin interesimin e qytetarëve?

- Tua kthejnë besimin qytetarëve në punën e tyre- qytetarët të kenë përvoja pozitive nga bashkëpunimi me institucionet
- Të punësojnë njerëz profesionistë dhe kompetentë
- Të jenë transparent në punën e tyre

Çka do t'i nxisë qytetarët? Nëse herë pas herë kanë rezultate pozitive. Nëse sheh se në anën tjetër është dikush që do të të dëgjojë dhe di se si të të ndihmojë.
Pjesëmarrës i fokus grupit, Strumicë



**ARSIMIMI QYTETAR FORMAL DHE JOFORMAL DHE
ARSIMIMI I VOTUESVE**

ARSIMIMI QYTETAR DHE ARSIMIMI I VOTUESVE

ARSIMIMI FORMAL

- Arsimim qytetar i detyrueshëm në klasën e 8-të dhe të 9-të në arsimin fillor
- Arsimim qytetar i detyrueshëm në vitin e 1-rë të arsimit të mesëm profesional; sociologji në arsimin e mesëm
- Lënda kulturore qytetare është vënë në 2002, në 2005 është riemërtuar në arsimim qytetar
- Në vitin 2020 MASH-i miratoi Konceptin dhe udhëzimet për zbatimin e Arsimimit qytetar në arsimin fillor të përpiluar nga BZHA-ja.
- Koncepti dhe udhëzimet kanë për qëllim që ta theksojnë më tej rëndësinë e integritit të Arsimimit qytetar në sistemin arsimor dhe se kultura demokratike është përgjegjësi e shkollës. Arsimimi qytetar realizohet përmes: programit të përkushtuar mësimor në lëndën e Arsimimit qytetar; aktivitete jashtëshkollore; udhëheqje demokratike me shkollat; bashkëpunimi me komunitetin; metoda mësimore të përshtatshme dhe ngjashëm.




ARSIMIMI JOFORMAL

Arsimimi qytetar joformal dhe arsimimi i votuesve zbatohet nga:

- Organizatat joqeveritare
- Partitë politike
- Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve
- Organizatat ndërkombëtare

ARSIMIMI QYTETAR

Në shoqëritë demokratike, arsimimi qytetar i nxit nxënësit që të jenë aktivë, qytetarë të përgjegjshëm dhe të informuar, të cilët kanë dëshirë dhe aftësi të marrin përgjegjësi për ta dhe komunitetet e tyre në nivel lokal, rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar. **Deri në ç 'shkallë arsimit ynë është i suksesshëm në këtë pikëpamje?**



Përqindja e të anketuarve që deklaruan se arsimi ynë nuk është i suksesshëm, sipas përkatësisë etnike



Përqindja e të anketuarve që deklaruan se arsimi ynë nuk është i suksesshëm, sipas vendbanimit



Qytet
54%



Fshat
45%

Baza: 1114 (të gjithë të anketuarit)
Margjina e gabimit ± 2.94

ARSIMIMI QYTETAR DHE ARSIMIMI I VOTUESVE

INTERVISTA TË THELLUARA

Të gjithë faktorët kryesorë pajtohen se Arsimimi qytetar dhe arsimimi i votuesve nuk janë përfshirë mjaftueshëm në procesin arsimor dhe se nuk i arrijnë efektet dhe qëllimet

Intervistat e thelluara me profesionistë kryesorë, i identifikojnë faktorët e mëposhtëm të cilët kanë ndikim në efektivitetin e arsimimit qytetar dhe arsimimit të votuesve:

- Lënda është abstrakte, teorike, komplekse, temat janë të pakuptueshme, mungon praktika
- Të rinjtë e përjetojnë si joadekuate dhe kanë averzion ndaj lëndës, veçanërisht ngase mendojnë se është e pazbatueshme në realitetin në të cilin jetojnë
- Lëndës nuk i është dhënë rëndësi e duhur, përfaqësohet vetëm me një orë në javë dhe shfrytëzohet për plotësimin e mungesës së orëve të disa arsimtarë
- Kadri mësimor është i profilit të ndryshëm profesional
- Nuk ka këshilltar të emëruar zyrtarisht për Arsimim Qytetar në Byronë e Zhvillimit të Arsimit, mungon supervizioni i arsimtarëve të cilët e ligjërojnë lëndën

Mendoj se arsimimi qytetar nuk është mjaftueshëm efikas, më së shumti ngase mësohen koncepte të stërndërlukuara në moshë mjaft të vogël, ndërsa çështjet themelore nuk përfshijnë aktivizmin dhe ndërmarrësinë, përkatësisht, pjesëmarrjen e qytetarëve. Aq artificialisht është bërë, aq është ai në një nivel që nuk i përshtatet kësaj gjeneratës së re që mendoj se me të vërtetë krijon tek ta njëfarë refuzimi.

Intervistë e thelluar me përfaqësues të partisë politike

Nxënësit menjëherë vërejnë se atë që e mësojnë dhe çka është e shkruar, për arsimimin qytetar, në librat shkollorë dhe programet, që është parashikuar ta marrin si mesazh, nuk përkon me atë që e shohin në jetën reale. Është kontradiktore. Për shembull, sheh korrupsionin në mjedisin përreth, sheh diskriminimin, dhe këtu kanë konflikt.

Intervistë e thelluar me përfaqësues të sektorit të OJQ-së



ARSIMIMI QYTETAR DHE ARSIMIMI I VOTUESVE

INTERVISTA TË THELLUARA

Një numër i madh Organizatash Joqeveritare punojnë në fushën e arsimimit qytetar dhe arsimimit të votuesve, një pjesë në shkolla, e një pjesë në edukimin e target grupeve të ndryshme të qytetarëve, partive politike dhe mediave (si p.sh. MCGO, Most, Civil, Inkluziva, Të rinjtë munden, QMBN, EPI, IDCS, CUP, ESMA, Lobi femëror maqedonas etj.)

- Ekziston përshtypja se organizatat joqeveritare dhe qytetare punojnë ad hok, në mënyrë josistematike dhe çdo gjë varet nga grandet dhe programet e donatorëve
- Punojnë në mënyrë të izoluar, pa bashkërendim, pa planifikim dhe nuk e shfrytëzojnë përvojën e projekteve të mëparshme të suksesshme
- Projektet nuk kanë vazhdimësi dhe konsistencë
- Nuk punohet mjaftueshëm në përgatitjen e institucioneve për vendosjen e ndryshimit, as në motivimin e çdo pale të prekur. Për këtë gjë, madje, edhe projektet e suksesshme bëhen jo të qëndrueshme nga çasti kur institucionet u lihen fatit të tyre, pa kontroll dhe monitorim

Duhet të ketë njëloj qendre, ueb faqe ose regjistër, që të shihet se cila organizatë punon në cilin projekt dhe në cilën çështje. Kjo qendër do të parandalojë mbivendosjen...

Intervistë e thelluar me përfaqësues të Akademisë

Është e lehtë të prishësh një sistem që është i brishtë! Duhet të ketë mekanizma të përfshirë paraprakisht në institucione. Nuk duhet t'u lihet aktorëve individualë (shkollave, mësuesve). Nuk kemi memorie institucionale. Sistemi i shkatërron madje edhe tregimet e suksesshme, kur institucionet u lihen fatit të tyre.

Intervistë e thelluar me përfaqësues të sektorit të OJQ-së


Ndjenja është se secili prej nesh po e bën punën ndaras, secili punon në projektet e veta dhe ndoshta nuk dimë për organizatat e tjera. Nëse të gjithë e ndajmë interesin e njëjtë, mund t'u bëjmë presion autoriteteve që të shtrihet kjo në mënyrë më sistematike, si „koalicioni për arsimimin qytetar“.

Intervistë e thelluar me përfaqësues të sektorit të OJQ-së




ARSIMIMI QYTETAR

Duke marrë parasysh faktin se në shkollat fillore ekziston lënda „arsimim qytetar“, a mendoni se kjo lëndë duhet të futet në të gjitha shkollat e mesme?



Përqindja e të anketuarve të cilët mendojnë se arsimimi qytetar duhet të futet në të gjitha shkollat e mesme, sipas nivelit arsimor




Do të ishte mirë që lënda të mësohej në të gjitha nivelet e arsimit, që të mos e harrojnë fëmijët. A nuk jetojmë, megjithatë, në një shtet qytetar, të jenë të edukuar mjaftueshëm, të dinë se si të sillen dhe çka të presin nga vetvetja dhe të tjerët.

Pjesëmarrës i fokus grupit, Manastir


Baza: 1114 (të gjithë të anketuarit)
Margjina e gabimit ± 2.94

ARSIMIMI QYTETAR

Sipas asaj që e dini, vallë arsimtarët dhe sistemi arsimor janë mjaftueshëm të përgatitur që të japin mësim dhe të promovojnë (të kyçin në aktivitetet jashtë mësimore) arsimimin qytetar/arsimimin e votuesve?



Përqindja e të anketuarve të cilët kanë paraqitur se arsimtarët nuk janë mjaftueshëm të përgatitur të japin mësim dhe të promovojnë, sipas grupmoshave



* 20% e të anketuarve të moshës prej 55+ nuk dinë se vallë arsimtarët dhe sistemi arsimor janë mjaftueshëm të përgatitur të japin mësim dhe të promovojnë arsimimin qytetar

Si do ta bëjë profesori më të afërt dhe sa seriozisht do ta marrë, aq edhe nxënësit do ta perceptojnë. Mendojnë se më e rëndësishme është se kush e mban atë lëndë.

Intervistë e thelluar me përfaqësues të sektorit të OJQ-së

Baza: 1114 (të gjithë të anketuarit)
Margjina e gabimit ± 2.94


Nuk ka vazhdimësi kuadri. Ne do t'i trajnojmë arsimtarët dhe në vitin e ardhshëm tashmë 30% prej tyre janë ndërruar. Ky është problem i madh. Ndonjëherë edhe fare të pakompletuar e ligjërojnë këtë lëndë...

Intervistë e thelluar me përfaqësues të sektorit të OJQ-së




ARSIMIMI QYTETAR DHE ARSIMIMI I VOTUESVE

Vallë keni ndjekur ju personalisht orë mësimi ose trajnim për arsimimin qytetar/edukimin e votuesve?




Përqindja e të anketuarve të cilët deklaruan kanë ndjekur mësimin ose trajnimin për arsimimin qytetar dhe arsimimin e votuesve, sipas grupmoshave



Baza: 1114 (të gjithë të anketuarit)
Margjina e gabimit ± 2.94

% NDËRMJET ATYRE QË KANË MARRË MËSIM OSE TRAJNIM PËR ARSIMIMIN QYTETAR/ ARSIMIMIN E VOTUESVE




VËREJTJE

- 64% e të anketuarve të moshës deri në 34 vjeç kanë ndjekur mësimin ose trajnimin në arsimin fillor/ të mesëm.

ARSIMIMI QYTETAR DHE ARSIMIMI I VOTUESVE

A besoni se arsimimi qytetar dhe edukimi i votuesve kontribuojnë për një përfshirje proaktive të qytetarëve në shoqëri?



ARSIMIMI QYTETAR DHE ARSIMIMI I VOTUESVE

Gjetjet nga intervistat e
thelluara me
profesionistë kyçë

Cilat tema duhen përfshirë?

- Demokracia, autoritarizmi, ideologjia, kultura politike
- Diskriminimi, respektimi i dallimeve, përfshirja, kohezioni social, zgjidhja e konflikteve
- Roli i organizatave joqeveritare dhe qytetare, financimi i tyre, aktivizmi qytetar
- Funksionimi i shtetit dhe institucioneve, sistemi politik, ndarja e pushtetit
- Zgjedhjet dhe sistemi zgjedhor (shteti, procesi zgjedhor, fushatat, partitë politike)
- Korrupsioni, njohja dhe mënyrat e kundërshtimit të korrupsionit
- Llogaridhënia dhe transparenca

Në të 8-tën dhe të 9-tën të jetë me hapa të vegjël ku nxënësit do të angazhohen në angazhime të shkurtra vullnetarisht, e më pastaj kur do të arrijnë në të mesmen të mundësohen të bëjnë projekt së bashku ose individualisht. Gjatë atyre viteve duhet të inkuadrohen ose në disa organizata qytetare ose në organizata bamirëse ku do të mund të bëjnë diçka dhe do ta shijojnë këtë. Kur është në nivel konceptesh, nuk u hyn në kokë

Intervistë e thelluar me përfaqësues të sektorit të OJQ-së

Mënyra e përmirësimit

- **Praktika dhe përafrimi praktik** i koncepteve
- **Vullnetarizmi, inkuadrimi** në organizatat qytetare
- Përfshirja e pushtetit vendor në projekte konkrete në komunitet
- **Informacione të thjeshta, konkrete**, lidhur me shkathtësitë që të rinjtë menjëherë mund t'i zbatojnë dhe përdorin
- **Analizimi i informacioneve dhe marrja e vendimeve të informuara**
- **Bashkëpunimi ndërmjet faktorëve të ndryshëm** (arsimi, sektori afarist, institucionet)

*Ç'do të thotë modeli i Dontit? Si bëhen koalicionet? Çka duhet të dish kur do të shkosh për herë të parë të votosh?
A e di se ka programe partiake? Sa i lexon programet? Kur do ta lexosh atë, çfarë domethënie ka për ty?
Domethënë, të dinë që t'i analizojnë informacionet që të marrin vendim më të informuar*

Intervistë e thelluar me përfaqësues të sektorit të OJQ-së



Cilave grupe të synuara u është i nevojshëm arsimimi?

Të gjithë faktorët e intervistuar pajtohen se të gjithë qytetarëve në vendin tonë u është i nevojshëm arsimimi qytetar dhe arsimimi për votuesit

- Të rinjtë dhe votuesit të cilët votojnë për herë të parë janë target grupi më i rëndësishëm sipas faktorëve kyçë
- Arsimimi qytetar u është i nevojshëm edhe:
 - Grupeve të rrezikuara qytetare (persona me arsim të ulët, më të moshuar, persona me aftësi të kufizuara)
 - Partitë politike
 - Të punësuarit në institucione
 - Mediat

Unë më së shumti do të kisha punuar me, të ashtuquajturit First time voters. Gjasa është e madhe se nëse një person i ri del të votojë për herë të parë, do të dalë të votojë edhe më tej. Kështu është treguar kjo gjë nga aspekti sociologjik si fenomen i cili në masë të madhe është i saktë. Kjo është si një lloj shprehje, obligimi, përgjegjësie...

Intervistë e thelluar me përfaqësues të partisë politike

Më e rëndësishme për të rinjtë është që të dinë se çka është demokracia, mënyra se si realizohen zgjedhjet, llojet e ideologjisë për të parë se vallë dëshirojnë të angazhohen politikisht përmes partive, sepse mund të jenë aktivë politikisht edhe në mënyra tjera...


Intervistë e thelluar me përfaqësues të sektorit të OJQ-së



AKTIVIZMI QYTETAR

AKTIVIZMI QYTETAR


A do ta përshkruaje veten si qytetar aktiv (i angazhuar në veprime qytetare)?




75,7%

22,7%


Përqindja e të anketuarve të cilët nuk janë aspak aktivë, sipas gjinisë



Përqindja e të anketuarve të cilët nuk janë aspak aktivë, sipas grupmoshave




Përqindja e të anketuarve të cilët nuk janë aspak aktivë, sipas nivelit arsimor




AKTIVIZMI QYTETAR

A jeni përfshirë në aktivitete për zgjidhjen e një çështjeje të caktuar në 12 muajt e fundit? (p.sh., keni marrë pjesë në protestë, keni parashtruar ankesë, keni nisur ose mbështetur petition onlajn etj.)



Përqindja e të anketuarve të cilët nuk kanë qenë të angazhuar në veprime qytetare në 12 muajt të fundit, sipas gjinisë



Përqindja e të anketuarve të cilët nuk kanë qenë të angazhuar në veprime qytetare në 12 muajt të fundit, sipas nivelit arsimor




Përqindja e të anketuarve të cilët nuk kanë qenë të angazhuar në veprime qytetare në 12 muajt të fundit, sipas grupmoshave



Baza: 1114 (të gjithë të anketuarit)
Margjina e gabimit ± 2.94


AKTIVIZMI QYTETAR

A ju ka pyetur ose ftuar ndonjë institucion për këshillë ose informacion gjatë marrjes së një vendimi të caktuar në nivelin qendror dhe lokal?



Baza: 1114 (të gjithë të anketuarit)
Margjina e gabimit ± 2.94


Përqindja e të anketuarve të cilët nuk janë thirrur ose këshilluar nga asnjë institucion, sipas gjinisë



Përqindja e të anketuarve të cilët nuk janë thirrur ose këshilluar nga asnjë institucion, sipas grupmoshave




Përqindja e të anketuarve të cilët nuk janë thirrur ose këshilluar nga asnjë institucion, sipas nivelit arsimor



VETËDIJE PËR OJQ-të DHE ORGANIZATAT QYTETARE

Cila nga deklaratat e mëposhtme më së miri e përshkruan njohjen tuaj për OJQ-të/organizatat qytetare në komunitetin tuaj?



Baza: 1114 (të gjithë të anketuarit)
Margjina e gabimit ± 2.94


Përqindja e të anketuarve të cilët nuk janë të informuar për asnjë OJQ ose organizatë qytetare në komunitetin e tyre, sipas gjinisë



Përqindja e të anketuarve të cilët nuk janë të informuar për asnjë OJQ ose organizatë qytetare në komunitetin e tyre, sipas grupmoshave




Përqindja e të anketuarve të cilët nuk janë të informuar për asnjë OJQ ose organizatë qytetare në komunitetin e tyre, sipas nivelit arsimor



MOTIVIMI I TË QENIT I ANGAZHUAR NË AKTIVITETE QYTETARE

Sipas jush, cilat janë arsyt kryesore për përfshirjen e qytetarëve në OJQ-të/Organizatat qytetare?

JANË TË MUNDSHME MË SHUMË PËRSGJIGJE
SHUMA E % TEJKALON 100



KRYESORE 2

Kur fillova të punoj në një organizatë joqeveritare, kemi shkuar nga kompania në kompani, kemi kërkuar sponsorë që të bëjmë paqeta për fëmijët e kërcënuar nga aspekti social për Vitin e Ri. Ndërsa, sot nëse thërret ndonjë të ri për t'u angazhuar të thotë: "sa do ta kem rrogën ose çka përfitoj unë?"

Pjesëmarrës i fokus grupit, Kumanovë


Nuk janë të gjitha njësoj, po ato që i njoh unë, e njoh shumë organizata joqeveritare çdo gjë lidhet me profitin...

Pjesëmarrës i fokus grupit, Manastir

MOTIVIMI I TË QENIT I ANGAZHUAR NË AKTIVITETE QYTETARE

Sa jeni të motivuar për aktivizmin qytetar (për shembull, të merrni pjesë në protestë, të parashtroni ankesë, të nisni ose mbështetni një peticion onlajn etj.) që të inkuadroheni në zgjidhjen e çështjeve që janë të rëndësishme për Ju?



Përqindja e të anketuarve të cilët nuk janë të motivuar aspak për angazhimin qytetar, sipas gjinisë



Përqindja e të anketuarve të cilët nuk janë të motivuar aspak për angazhimin qytetar, sipas përkatësisë etnike




Përqindja e të anketuarve të cilët nuk janë të motivuar aspak për angazhimin qytetar, sipas nivelit arsimor



Baza: 1114 (të gjithë të anketuarit)
Margjina e gabimit ± 2.94

SHKAQET E APATISË QYTETARE

Cili është shkaku kryesor që Ju dekurajon të angazhoheni në veprime qytetare (p.sh. të merrni pjesë në protestë, të parashtroni ankesë, të nisni ose të mbështetni një peticion onlajn)?



SHKAKU KRYESOR

SHKAQET E APATISË SË QYTETARËVE

Cili është shkaku kryesor që ju dekurajon të jeni qytetarë aktivë?

Fokus grupet

- Frika nga ekzistenca personale, frika nga revanshizmi dhe humbja e vendit të punës (së vet apo të anëtarit të familjes)
- Bindja se çdo gjë është e kotë dhe se qytetarët nuk kanë fuqi të ndryshojnë asgjë në shoqëri
- Politizimi i aktivizmit qytetar dhe shfrytëzimi i tij për interesa partiake
- Në kushtet e varfërisë dhe situatës së keqe ekonomike në vend, interesi i qytetarëve për aktivizmin qytetar është më pak i rëndësishëm

Mendoj se shumica do të ishin aktivë në shoqëri kur do të kishin motiv të fuqishëm dhe besim se diçka do të ndryshohet, se angazhimi i tyre do të jetë për të mirën e përgjithshme, të mirën e të gjithëve. Por ai besim te njerëzit është shumë i vogël...

Pjesëmarrës i fokus grupit, Manastir

Dua të them se e gjithë jeta është një luftë, megjithatë njeriu ynë frikësohet se do të nxihet, se do të mbyllet, se do të nënçmohet. Mendoj se frika mbizotëron më shumë sesa padituria ...

Pjesëmarrës i fokus grupit, Shkup

Njerëzit nuk janë aktivë sepse mendojnë se asgjë s'mund të ndryshojnë dhe se do të kenë pasoja për veten dhe të afërmit e tyre.

Pjesëmarrës i fokus grupit, Kumanovë


Poenta e sektorit qytetar është që të bëjë diçka që do jetë në dobi të shoqërisë. Por në realitet, çfarëdo që do të thuash, gjithmonë do të gjejnë ndonjë prapavijë politike dhe menjëherë do të mendojnë se i përket ndonjë partie politike...

Pjesëmarrës i fokus grupit, Kumanovë



FUSHAT E ANGAZHIMIT QYTETAR


Cila nga fushat e mëposhtme mund të jetë me interes për Ju që të angazhoheni në veprime qytetare (p.sh. të merrni pjesë në një protestë, të parashtroni ankesë, të nisni ose mbështesni një peticion online, etj.)?



ANËTARËSIMI NË ORGANIZATA

A jeni anëtar ose keni qenë të inkuadruar në ndonjë nga organizatat e mëposhtme?

JANË TË MUNDSHME MË SHUMË PËRGJIGJE
SHUMA E % ËSHTË MË TEPËR SE 100



VËREJTJE

- **Mosinteresimi, mospasja e kohës dhe mospasja e besimit** janë më shpesh shkaqet e përmendura për mos inkuadrim në asnjë organizatë.

Personalisht jam shumë e dëshpëruar nga shteti, sepse çdo herë që na nevojitet ndihma e shtetit, jo vetëm mua por edhe familjes sime, asnjëherë nuk e kemi marrë atë ndihmë. Për atë shkak shmangem, singërisht, që të inkuadrohem në cilëndo organizatë joqeveritare ose organizatë studentësh.

Pjesëmarrës i fokus grupit, Shkup

ZGJEDHJET

ASOCIACIONET PËR ZGJEDHJET

Kur do të duhej t'i përshkruanit zgjedhjet në vendin tonë me **3 fjalë** cilat do të ishin ato?

Gjetje nga
hulumtimi
cilësor

Fokus grupi

- Të lira
- Të qeta
- Të gjithë janë fitues, të gjitha partitë festojnë fitoren në ditën e zgjedhjeve

- Premtime boshe
- Korrupsion
- Kaos
- Zgjedhje pa përzgjedhje, nuk vendos vullneti i popullit, vendosin "forcat tjera"
- Jokorrekte, joreale




Zgjedhjet janë të lira për një pjesë më të madhe të popullatës, por pjesa tjetër e dimë se i ka problemet e veta. Ndoshta për mua janë të lira, por për dikë tjetër nuk janë të lira...

Pjesëmarrës i fokus grupit, Tetovë

NDJENJA E PËRFAQËSIMIT NGA PERSONAT E ZGJEDHUR

Sipas Jush, a besoni se deputetët ose këshilltarët komunalë i përfaqësojnë nevojat dhe interesat Tuaja, pasi që janë zgjedhur?



VËREJTJE


- Qytetarët që nuk besojnë se në përgjithësi i përfaqësojnë deputetët ose këshilltarët komunalë më së shpeshti janë:
 - Bashkësi etnike tjera
 - Qytetarët me arsim fillor
 - Grup mosha 55 +
 - Jetojnë në mjedis urban

Para se të zgjidhen vazhdimisht kanë qasje në telefon dhe janë në kontakt me ne. Por, nëse të ndodh ta thërrasësh pas ardhjes së tij në funksion, është interesante se ai nuk e dëgjon telefonin, ose telefoni nuk funksionon.... Ata tekstualisht nuk na mbajnë mend. Unë nuk kam parë që ndonjë pjesëmarrës i ndonjë partie politike të më ketë përfaqësuar mirëfilli.

Pjesëmarrës i fokus grupit, Kumanovë

INTERESIMI PËR ZGJEDHJET

A jeni i/e interesuar të kuptoni diçka më tepër për zgjedhjet? (fushatën, kandidatët, listën e zgjedhësve, programet partiake, procesin e votimit, rezultatet)



Baza: 1114 (të gjithë të anketuarit)
Margjina e gabimit \pm 2.94

Përqindja e të anketuarve të cilët janë të interesuar të mësojnë diçka më tepër për zgjedhjet, sipas vendbanimit



Qytet
32%



Fshat
38%

Përqindja e të anketuarve të cilët janë të interesuar të mësojnë diçka më tepër për zgjedhjet, sipas gjinisë

Mashkullor 38%

Femëror 31%

Përqindja e të anketuarve të cilët janë të interesuar të mësojnë diçka më tepër për zgjedhjet, sipas nivelit arsimor


Fillor 25%

I mesëm 35%

I lartë 41%


INTERESIMI PËR ZGJEDHJET

Për çka më shumë jeni i/e interesuar të mësoni?




Qytetarët janë të interesuar vetëm për kandidatët, çfarë njerëz janë ata, çfarë qëndrime kanë për çështjet që u janë të rëndësishme dhe si paraqiten ata.

Intervistë e thelluar me përfaqësues të sektorit të OJQ-së



INTERESIMI PËR ZGJEDHJET

Për çka më shumë jeni i/e interesuar të mësoni?



Çka nëse dini më shumë? Nuk mund të ndryshosh asgjë, kur nuk vendos ti.


Pjesëmarrës i fokus grupit, Shtip

% NDËRMEJT ATYRE QË NUK JANË TË INTERESUAR TË MËSOJNË PËR ZGJEDHJET



INTERESIMI PËR PËRFSHIRJEN NË PROCESIN ZGJEDHOR

A do të ishte personalisht i/e interesuar që të përfshihen më shumë në procesin zgjedhor si...?



Baza 1114 (të gjithë të anketuarit)
Margjina e gabimit ± 2.94

INTERESIMI PËR PËRFSHIRJEN NË PROCESIN ZGJEDHOR

Gjetje nga hulumtimi
cilësor

A do të ishit personalisht të interesuar që të përfshiheshit më tepër në procesin zgjedhor si...?

- Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve në fokus grupet **nuk janë të interesuar aspak** që të përfshihen në proceset zgjedhore në asnjë mënyrë.
- Të punësuarit në administratën publike përfshihen në proceset zgjedhore si anëtarë ose kryetarë të komisioneve zgjedhore vetëm se e kanë patjetër për t'u përfshirë, por te shumica vërehen rezistenca të mëdha. Procesin e vlerësojnë të lodhshëm, të vështirë dhe shumë përgjegjës. Te një pjesë ekzistojnë edhe shqetësime nga konflikte të mundshme dhe parregullsi.
- Te një pjesë e vogël (veçanërisht te punonjësit arsimorë) vërehet interesim për t'u përfshirë në proceset e edukimit dhe arsimimit të votuesve, veçanërisht të rinjve dhe të atyre që votojnë për herë të parë.



Nëse më vënë në komision - s'kemi se si, nuk guxon të refuzosh.
Pjesëmarrës i fokus grupit, Shkup


Vullnetarisht nuk isha paraqitur, sinqerisht disi është i lodhshëm procesi, ndërsa përgjegjësia është e madhe.
Pjesëmarrës i fokus grupit, Manastir

*Nuk do të isha përfshirë as në komision as si vëzhgues, sepse nuk e di se çka mund të ndodhë aty për aty.
Nuk më shkohet nga shkakut e atyre konflikteve dhe parregullsive.*


Pjesëmarrës i fokus grupit, Kumanovë

INFORMACIONE PËR ZGJEDHJET


A mendoni se keni informacione të mjaftueshme që të bëni zgjedhje të informuar kur votoni?




Përqindja e të anketuarve të cilët deklaruan se nuk kanë informacione të mjaftueshme që të zgjedhin gjatë votimit, sipas gjinisë



Përqindja e të anketuarve të cilët deklaruan se nuk kanë informacione të mjaftueshme që të zgjedhin gjatë votimit, sipas grupmoshave



Përqindja e të anketuarve të cilët deklaruan se nuk kanë informacione të mjaftueshme që të zgjedhin gjatë votimit, sipas nivelit arsimor



INFORMACIONE PËR ZGJEDHJET

A mendoni se keni informacione të mjaftueshme që të bëni zgjedhje të informuar kur votoni?

Intervista me mediat

- Përfaqësuesit e medimeve vërejnë se në hapësirën mediatike mungojnë informacionet që do t'u ndihmonin qytetarëve të bënin zgjedhje dhe vendime të informuara
- Informacionet në mediat mjaft shpesh nuk janë analitike, nuk janë të përpunuara hollësisht, nuk bëjnë observime kritike të ngjarjeve dhe programeve zgjedhore të politikanëve dhe të partive politike, as krahasimin e tyre
- Mungon edukimi shtesë për sistemin zgjedhor në vendin tonë, procedurat e votimit, të drejtat dhe detyrimet zgjedhore

Problemi është se qytetarët u ekspozohen vazhdimisht modelit të njëjtte të informacioneve me vite të tëra, të cilat nuk u ndihmojnë të bëjnë zgjedhje dhe vendime të informuara

Intervistë e thelluar me përfaqësues të mediave


Nuk ekziston ai dimension i edukues-çfarë është sistemi ynë zgjedhor, procesi, hapat, të bëhet paralele cilat janë platformat, cilat janë programet e veprimt, cilat janë premtimet zgjedhore... Që t'u mundësohet votuesve për t'u përkujtuar se vallë ajo që ishte premtuar është realizuar. Ka njerëz që nuk janë të informuar aspak rreth këtyre gjërave, ndërsa duhet të dinë.

Intervistë e thelluar me përfaqësues të mediave



INFORMACIONE PËR ZGJEDHJET


Duke menduar për zgjedhjet e fundit (zgjedhjet lokale 2021), a keni parë ose dëgjuar ndonjë fushatë edukuese lidhur me zgjedhjet?



Baza 1114 (të gjithë të anketuarit)
Margjina e gabimit \pm 2.94


Kishte në televizion para zgjedhjeve, reklamë për të drejtat e votuesve. Ishte e animuar dhe e shkurtër, e bërë bukur, mbetet në kujtim. Mendoj se ishte e KSHZ-së.

Pjesëmarrës i fokus grupit, Manastir




PARAQITJA E PARREGULLSIVE


Nëse keni qenë i/e ekspozuar ndaj presionit, siç janë: forca, kërcënimet, blerja e votave ose veprimtaritë tjera jashtëligjore (me çka Ju është bërë presion që të votoni në njëfarë mënyre), a keni informacione të mjaftueshme se ku do ta paraqisni rastin?



Përqindja e të anketuarve të cilët nuk janë të informuar se ku të paraqesin, sipas gjinisë




Përqindja e të anketuarve të cilët nuk janë të informuar se ku të paraqesin, sipas nivelit arsimor



PERCEPTIMI PËR KSHZ-NË

PERCEPTIMI PËR KSHZ-në

A mendoni se KSHZ-ja është institucion profesional dhe i pavarur?



Përqindja e të anketuarve të cilët mendojnë se KSHZ-ja është institucion profesional dhe i pavarur, sipas vendbanimit




Qytet
39%




Fshat
47%

Përqindja e të anketuarve të cilët mendojnë se KSHZ-ja është institucion profesional dhe i pavarur, sipas nivelit arsimor



PERCEPTIMI PËR KSHZ-në

Deri në ç' shkallë pajtoheni apo nuk pajtoheni me këto deklaratata?



Baza 1114 (të gjithë të anketuarit)
Margjina e gabimit ± 2.94

ARSIMIMI SISTEMOR I INSTITUCIONEVE SHETËRORE

Gjetje nga intervista të thelluara me profesionistë kyçë

Cilat institucione shtetërore duhet të sigurojnë arsimimin sistemor?

- **KSHZ-ja konsiderohet si institucion shtetëror më i përshtatshëm për të ofruar shërbime për votuesit dhe faktorët tjerë zgjedhorë**
- KSHZ duhet të jetë bartës (ta luajë rolin kryesor) të një projekti më gjithëpërfshirës i cili do të përfshijë edhe shumë faktorë tjerë si donatorë ndërkombëtarë, organizata joqeveritare, media dhe parti politike.

Perceptimi i efikasitetit dhe kapaciteteve të KSHZ-së

- Në përgjithësi ekziston dyshimi në kapacitetet dhe mundësitë e KSHZ-së që të zbatojë edukim sistematik jashtë fushatave që i zbaton për zgjedhjet
- Një pjesë dyshojnë në kredibilitetin e institucionit dhe besimit që ka te qytetarët, respektivisht mundësinë për angazhimin e tij profesional dhe politikisht të pavarur

Mënyra e përmirësimit

- Analiza funksionale, përmirësimi i politikave të punës
- Partneriteti me sektorin qytetar, mediat, donatorët ndërkombëtarë
- Rritja e integritetit, besimit dhe transparencës së institucionit, profesionalizmit
- Krijimin e institutit për zgjedhjet, me këtë buxhet vjetor, lidhur me shërbimin profesional, i pavarur nga përfaqësuesit politikë
- Zgjerimin e ekipit me ekspertë, punonjës akademikë dhe hulumtues

ARSIMIMI SISTEMOR I INSTITUCIONEVE SHETËRORE

Gjetje nga intervista të thelluara me profesionistë kyçë

Intervista të thelluara: KSHZ si qendër arsimore trajnimi

- Qendra e trajnimit të KSHZ-së **duhet të jetë pjesë e veçantë e KSHZ-së**, me të **punësuarit e vet**, buxhetin e vet i cili do të jetë i **vazhdueshëm**, e jo vetëm në vitin zgjedhor; buxheti duhet të **mos varet nga mjetet donatore**.
- Qendra e trajnimit duhet të ketë **2 pjesë** (funksione): pjesa edukuese dhe pjesa për hulumtime dhe analizë.
- **Trajnimet dhe ushtrimet** të cilat KSHZ do t'i zbatojë duhet t'i **dedikohen të gjithëve**:
 - qytetarëve (grupeve të ndryshme të synuara, nxënësve, studentëve, grave, qytetarëve të rrezikuar, qytetarëve me nevoja të veçanta etj.)
 - partive politike
 - mediave
 - të punësuarve në institucione
- Në ueb faqen e tij, KSHZ duhet të vazhdojë me platformën edukuese me kurset onlajn për edukimin e votuesve, me temat për arsimimin qytetar, por kjo platformë duhet më tepër të promovohet që sa më shumë ta vizitojnë qytetarët.

Që të mund të funksionojë nevojitet:


- Ndryshimi i rregullativës ligjore
- Sigurimi i hapësirës së përshtatshme
- Sigurimi i financave
- Sigurimi i resurseve njerëzore



RËNDËSIA E MEDIAS PËR ARSIMIMIN QYTETAR DHE ARSIMIMIN E VOTUESVE

BURIMET E INFORMACIONIT

Cili është burimi Tuaj parësor i informacionit për zhvillimet aktuale socio-politike?



Baza 1114 (të gjithë të anketuarit)
Margjina e gabimit ± 2.94

Kanë më shumë gjasa të informohen nga rrjetet sociale:

- Më të rinjtë (prej 18-34 vjeç)
- Maqedonasit etnikë
- Me arsim të lartë
- Vendbanime urbane
- Të ardhura më të larta familjare (51.000+ den.)
- E vlerësojnë amvisërinë e vet ekonomikisht mirë.




Kanë më shumë gjasa të informohen nga TV-ja:

- Gratë
- Më të moshuarit (e moshës 55+)
- Bashkësitë tjera etnike
- Me arsim fillor
- Vendbanime rurale
- Të ardhura më të ulëta familjare (më pak se 31.000 ден.)
- E vlerësojnë amvisërinë e vet të varfër.



MEDIAT DHE PJESËMARRJA QYTETARE


Sa konsideroni se mediat janë të rëndësishme për informimin e njerëzve për çështjet që prekin komunitetet e tyre dhe t'i inkurajojnë që të marrin pjesë?



Përqindja e të anketuarve të cilët **besojnë se mediat janë shumë të rëndësishme për informimin e njerëzve për çështjet që prekin komunitetet e tyre dhe i inkurajojnë që të marrin pjesë, sipas përkatësisë etnike**



Përqindja e të anketuarve të cilët **besojnë se mediat janë shumë të rëndësishme për informimin e njerëzve për çështjet që prekin komunitetet e tyre dhe i inkurajojnë që të marrin pjesë, sipas nivelit arsimor**



MEDIAT DHE AKTIVIZMI QYTETAR



Gjetje nga intervistat
e thelluara me
profesionistë kyçë

Përfaqësimi në mediat

- Edhe përkundër përpjekjeve, **temat lidhur me shoqërinë civile nuk janë të pranishme mjaftueshëm në mediat dhe ndihet mungesë informacionesh** lidhur me aktivizmin qytetar dhe mënyrat e përfshirjes qytetare
- Shoqëria civile ka vendin e vet në njoftimin mediatik, para së gjithash përmes pranisë së përfaqësuesve të Shoqërisë civile në debatin publik, por kuptimi dhe rëndësia e fenomenit nuk është i pranishëm.

Përmbajtja mediatike


- Problemi është para së gjithash në mos përfaqësimin e temës, e jo në format e prezantimit të saj
- Më të përshtatshme janë zhanret edukuese të cilat mundësojnë ndërveprim më të gjerë dhe diskutim, debate, intervista të thelluara, rrëfime njerëzore, storje
- **Me rëndësi të veçantë është informimi konsekuent dhe i vazhdueshëm i këtyre temave, vendosja dhe identifikimi sistematik si tema me interes publik**

Kapacitetet e gazetarëve

- Rënie të cilësisë së studimeve për gazetari
- Kapaciteti dhe njohuria e gazetarëve në pjesë të madhe varet nga media në të cilën punojnë, nga përvoja dhe profesionalizmi i tyre
- **Ekzistojnë shumë përpjekje për edukimin e gazetarëve, por iniciativat nuk janë të sistematizuara, të bashkërenduara dhe të planifikuara ndërmjet donatorëve, organizatave qytetare, organizatave dhe shoqatave mediatike**

MEDIAT DHE ZGJEDHJET

Sa mendoni se mediat janë të rëndësishme për ngritjen e vetëdijes dhe informimin e qytetarëve për zgjedhjet?



Përqindja e të anketuarve të cilët konsiderojnë se mediat janë shumë të rëndësishme për ngritjen e vetëdijes dhe informimin e qytetarëve për zgjedhjet, sipas përkatësisë etnike



Nëse mediat nuk sigurojnë informacionin e duhur për qytetarët që të fitohet një pamje më gjithëpërfshirëse, atëherë praktikisht do të enden në përpjekjen për të marrë më shumë informacion. Këtu ndoshta do të hasin në informacione që shpeshherë publikohen në mediat sociale, por nuk do të thotë se janë të vërteta dhe të sakta, të vërtetuara, të balancuara etj. Që do të thotë se mediat kanë rol të rëndësishëm dhe rëndësi në këto procese, duke i siguruar informacionet që janë të domosdoshme dhe duke dhënë kontekstin dhe duke paraqitur anët e ndryshme...

Intervistë e thelluar me përfaqësues të mediave

PERCEPTIMI PËR MEDIAT

Deri në ç 'shkallë pajtoheni/nuk pajtoheni me deklaratat e mëposhtme

Pajtohen
(Tërësisht + deri diku)

Pajtohem plotësisht


Deri diku pajtohem

Deri diku nuk pajtohem


Aspak nuk pajtohem

Nuk di

Mediat në vendin tonë japin kontribut domethënës për përparimin e dialogut ndërmjet partive politike



Mediat janë të njëanshme dhe kanë prirje për shpërndarjen e lajmeve të rreme



Mediat promovojnë tolerancë, respekt reciprok, duke përfshirë dallimet



Mediat në vendin tonë informojnë për zhvillimet socio-politike në mënyrë objektive dhe të paanshme



Mediat në vendin tonë informojnë për zgjedhjet në mënyrë objektive dhe të paanshme



0 10 20 30 40 50 60 70 80 90 100

Baza 1114 (të gjithë të anketuarit)

Margjina e gabimit ± 2.94

PERCEPTIMI I MEDIAVE

Fokus grupe

- ✓ Në përgjithësi ekziston niveli i ulët i besimit për njoftimin e pavarur dhe objektiv të medias, për ç 'shkak qytetarët ndjekin media të ndryshme me qëllim që të sjellin përfundime në mënyrë të pavarur
- ✓ Njohin plasimin e dezinformatave dhe lajmeve të rreme në media, veçanërisht në ueb portalet dhe rrjetet sociale çka e zvogëlon ndjeshëm nivelin e besimit në informacionet e plasuara
- ✓ Një pjesë më e vogël (veçanërisht punonjësit e sektorit të arsimit) kanë pasur edukim për shkrim leximin mediatik, por theksohet nevoja e fushatave më masovike të publikut më të gjerë lidhur me këtë temë.

Mënyra në të cilën mediat informojnë ngjan në program të paguar politik. Ne jemi dëshmitarë të shumë dezinformatave ose informacioneve të shtrembëruara, kështu që personat përgjegjës duhet të merren me këtë punë

Pjesëmarrës i fokus grupit, Tetovë

Intervista të thelluara me mediat

- ✓ Ka shqetësim për praninë e gjithnjë e më tepër të dezinformatave, veçanërisht në mediat sociale dhe ueb portalet. Të njëjtat janë të koncentruara veçanërisht në fazat kritike të zhvillimeve në një shoqëri (pandemi, luftë edhe ngjashëm) për ç 'shkak janë jashtëzakonisht të rrezikshme
- ✓ Sektori qytetar, shoqatat profesionale mediatike, shërbimet për kontrollin e fakteve, e veçanërisht vetë mediat luajnë rol të rëndësishëm në trajtimin e dezinformatave

Kishte fushatë shumë të madhe rreth shkrim leximit mediatik dhe kishte shumë vëmendje një kohë në shoqëri për arsimimin mediatik.

Pjesëmarrës i fokus grupit, Shkup

GJETJET KRYESORE

GJETJET KRYESORE: GJENDJA E PËRGJITHSHME DHE VETËDIJA

Ekonomia dhe standardi jetësor janë problemet më të mëdha me të cilat përballen qytetarët. Besimi në institucionet është i ulët.

- Qytetarët janë të shqetësuar më shumë për çështjet ekonomike dhe standardin jetësor. Krimi, korrupsioni dhe sundimi i së drejtës më shpesh përmenden si probleme me të cilat përballen shteti, ndërsa më rrallë si problem prej të cilit qytetarët janë personalisht të prekur.
- Institucionet fetare dhe Armata janë institucione që gëzojnë besim më së shumti nga qytetarët. Gjyqet dhe Prokuroria publike janë institucione me besim më të ulët, në të cilat 80 % e qytetarëve nuk kanë besim.

Është vërejtur vetëdije e lartë për rëndësinë e njohjes së koncepteve dhe temave për arsimimin qytetar dhe arsimimin e votuesve. Ekziston konsensus ndërmjet të gjitha grupeve të synuara se qytetarët nuk janë të informuar mjaftueshëm për arsimimin qytetar.

- Shumica e madhe (92,8%) pajtohen se është e rëndësishme që qytetarët t'i dinë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre në një shoqëri demokratike dhe identifikojnë pasoja serioze nga mungesa e arsimimit qytetar – rrezik nga manipulimet, apati dhe pasivitet.
- Qytetarët janë më së paku të njohur lidhur me buxhetin shtetëror (60% janë tërësisht ose jo aq të njohur) dhe format e pjesëmarrjes së qytetarëve edhe aktivizmin qytetar (48% janë të njohur tërësisht ose jo dhe aq). Është vërejtur njohje më e madhe me procesin zgjedhor dhe të drejtat zgjedhore.
- Qytetarët i perceptojnë të drejtat e minoriteteve dhe lirinë e shprehjes si vlera demokratike të cilat në masë më të madhe ekzistojnë në vend; përderisa dënimi i sjelljes korruptive dhe llogaridhënia nuk janë të pranishme mjaftueshëm.

ARSIMIMI QYTETAR DHE PJESËMARRJA QYTETARE

Efektivitet i ulët i arsimimit qytetar formal dhe jo formal.

- Gjysma e qytetarëve konsiderojnë se arsimi ynë nuk është i suksesshëm në nxitjen e nxënësve që të jenë aktivë, qytetarë të informuar dhe të përgjegjshëm, me dëshirë dhe aftësi për të marrë përsipër përgjegjësi për vete dhe bashkësinë e vet (50,3%). Një e treta (33,6%) konsiderojnë se arsimtarët dhe sistemi arsimor nuk janë përgatitur mjaftueshëm që ta ligjërojnë dhe promovojnë arsimimin qytetar.
- Është e nevojshme qasja praktike ndaj koncepteve (vullnetarizmi, përfshirja në organizatat qytetare dhe projektet), thjeshtësimi i informacioneve të dhëna dhe bashkëpunimi ndërmjet arsimit, sektorit afarist dhe institucioneve me qëllim të përmirësimit të arsimimit formal dhe joformal.
- Përpjekjet e organizatave të ndryshme joqeveritare dhe qytetare janë të izoluara, jo të bashkërenduara, josistematike dhe të varura nga grantet dhe programet e donatorëve. Mospërgatitja e institucioneve që t'i vënë në zbatim ndryshimet, mungesa e memories institucionale dhe mungesa e kontrollit dhe monitorimit kanë ndikim më të madh në qëndrueshmërinë dhe vazhdimësinë e të gjitha projekteve.

Sipas të gjitha grupeve të synuara, të rinjtë dhe ata që votojnë për herë të parë kanë nevojë më të madhe të arsimimit qytetar dhe arsimimit të votuesve.

- Megjithatë, 6 nga 10 të rinj (të moshës prej 18 deri në 34 vjeç) nuk janë të interesuar për pjesëmarrje qytetare, përderisa dy të tretat besojnë se nuk do të ketë kurrfarë rezultati dhe ndryshim nga aktivizmi i tyre qytetar.

Pjesëmarrje e ulët qytetare dhe anëtarësimi në organizata.

- Vetëm 22,7% të qytetarëve e përshkruajnë veten si kryesisht ose vazhdimisht qytetarë aktivë, 14,4% janë përfshirë në aktivitete për zgjidhjen e një çështjeje të caktuar në 12 muajt e fundit, përderisa gjysma e qytetarëve nuk janë të informuar për asnjë OJQ ose organizatë qytetare në komunitetin e tyre.
- 60% e qytetarëve deklarojnë se nuk janë të motivuar që të merren me çështje të rëndësishme qytetare, kryesisht për shkak se nuk besojnë se ajo do të ndryshojë diçka.
- Pothuajse dy të tretat e qytetarëve nuk janë anëtarë të asnjë organizate, përderisa 18,2% janë përfshirë në parti politike.

GJETJET KRYESORE: ZGJEDHJET DHE PUNA E KSHZ-së

Qytetarët kanë asociacione negative për zgjedhjet dhe nuk ndiejnë se interesat dhe nevojat e tyre përfaqësohen nga personat e zgjedhur

- Shumica (67.2%) nuk ndihen të përfaqësuar nga anëtarët e parlamentit ose komunës pasi që janë zgjedhur të njëjtit.
- Një e treta (34,6%) janë të interesuar të mësojnë më tepër për zgjedhjet, e më së shumti për kandidatët dhe programet politike. Është vërejtur interesim i dobët për përfshirje në procesin zgjedhor si kandidat, vullnetar, vëzhgues dhe anëtar i organit zgjedhor. Gjysma e qytetarëve nuk dinë se ku të paraqesin poqë se i ekspozohen presionit për të votuar në një mënyrë të caktuar.
- Rrjetet TV dhe sociale janë burimet e informacionit më shpesh të përdorura për zgjedhjet.
- Shumica e qytetarëve (72,4%) konsiderojnë se kanë informacione të mjaftueshme për të bërë zgjedhje të informuar gjatë votimit. Megjithatë, përfaqësuesit e mediave theksojnë se mediat nuk ofrojnë përmbajtje edukuese për sistemin zgjedhor në vend dhe nuk japin analizë dhe krahasim të programeve zgjedhore të partive politike.

Ekziston konsensusi se KSHZ duhet të jetë bartës kryesor i edukimit sistematik të votuesve dhe të faktorëve të tjerë zgjedhorë. Duhet tejkaluar dyshimet mbi kapacitetin, profesionalitetin dhe pavarësinë e KSHZ-së për edukim sistematik.

- Rreth tre të katërtat e qytetarëve pajtohen se KSHZ duhet të sigurojë edukimin e votuesve, për grupe të ndryshme të synuara dhe faktorë të ndryshëm të zgjedhjeve dhe atë vazhdimisht, e jo vetëm në periudhat parazgjedhore.
- Pothuajse 44% e qytetarëve nuk besojnë se KSHZ është institucion profesional dhe i pavarur. Si plotësim, dyshimet në kapacitetin, kredibilitetin dhe punën e pavarur politike të KSHZ-së janë shprehur nga faktorë relevantë të ndryshëm (OJQ, media, përfaqësues të partive politike).
- Faktorët relevantë konsiderojnë se qendra e trajnimit e KSHZ-së duhet të jetë pjesë e veçantë e KSHZ-së, politikisht e pavarur, me të punësuarit e vet dhe buxhetin e vet; në partneritet me sektorin qytetar, mediat dhe donatorët ndërkombëtarë.

GJETJET KRYESORE: MEDIAT

Mediat janë shumë të rëndësishme për ngritjen e vetëdijes dhe informimin e qytetarëve për temat e aktivizmit qytetar.

Në përmbajtjet mediatike ende mungojnë informacionet lidhur me aktivizmin qytetar dhe format e pjesëmarrjes qytetare. Shumica e qytetarëve dhe përfaqësuesit e mediave janë të brengosur për dezinformatat dhe përhapjen e lajmeve të rreme në mediat.

- Pothuajse 9 nga 10 qytetarë (87%) besojnë se mediat janë shumë ose deri diku të rëndësishme në informimin e qytetarëve për çështjet që prekin komunitetin e tyre dhe t'i inkurajojnë që të marrin pjesë. Përfaqësuesit e mediave propozojnë informim konsekuent dhe të vazhdueshëm për këto tema, iniciativa të sistemuara, të bashkërenduara dhe të planifikuara për përmirësimin e kapacitetit dhe njohurive të gazetarëve ndërmjet organizatave qytetare, shoqatave mediatike dhe donatorëve.
- 6 nga 10 qytetarë pajtohen se mediat janë të njëanshme dhe të prirura ndaj përhapjes së lajmeve të rreme. Përfaqësuesit e mediave ndajnë këtë brengë, veçanërisht në lidhje me ueb portalet dhe mediat sociale. Ata kërkojnë nga sektori qytetar, shoqatat mediatike dhe shërbimet për kontroll të fakteve të luajnë rol më aktiv në trajtimin e dezinformatave.

GJETJET KRYESORE

VETËDIJE

93% janë të vetëdijshëm se është e rëndësishme që qytetarët t'i dinë të drejtat dhe detyrimet e tyre në një shoqëri demokratike.

Mungesa e arsimimit qytetar sjell në nënshtrim ndaj manipulimeve, apati dhe pasivitet.



ARSIMIMI QYTETAR

50% e qytetarëve konsiderojnë se arsimi ynë nuk është i suksesshëm që të nxisë nxënësit të jenë qytetarë aktivë, të informuar dhe të përgjegjshëm.



PJESËMARRJA QYTETARE

30% e qytetarëve deklaruan se janë të motivuar, përderisa **60%** deklaruan se nuk janë të motivuar për pjesëmarrjen qytetare, më së shumti nga shkakut se nuk besojnë se kjo do të bëjë ndryshim.



KSHZ QENDËR TRAJNIMI

76% besojnë se KSHZ duhet të jetë bartës kryesor i edukimit të votuesve

Qytetarët dhe palët e prekura relevante janë të brengosura për profesionalizmin, kapacitetin dhe pavarësinë e angazhimit politik të KSHZ-së si bartës i arsimimit sistematik të grupeve të ndryshme të synuara.



MEDIAT

TB (53%), Media sociale(25%) dhe Ueb portale(10%) janë burime dominuese të informacioneve për zhvillimet shoqërore-politike

Ekziston mungesë e përgjithshme informacionesh lidhur me aktivizmin qytetar dhe mënyrat e përfshirjes qytetare në media.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra



Ky prezantim është përpunuar në kuadër të projektit „Mbështetje të reformave zgjedhore” i financuar nga Qeveria e Zvicrës dhe i implementuar nga Fondacioni ndërkombëtar për sistemet zgjedhore (IFES). Qëndrimet, mendimet dhe përmbajtjet e shprehura në këtë prezantim s’do të thotë se i pasqyrojnë qëndrimet e donatorit, projektit ose implementuesit.